

# Periudha naziste në Itali

Giovanna Boursiers

Çështja e racës | Nga teoria në praktikë | Internimi | Kampi | Pas armëpushimit

➤ Në Itali viktimat e diktaturës fashiste gjithashtu përfshinin romët. Sot, derisa hetimi historik i lëndës vetëm sa po fillon dhe duhet të luftojë me më shumë se gjysmë shekulli të mospërfilljes pak a shumë të qëllimshme dhe “humbjes së kujtesës”, mund të themi me siguri se romët u ndoqën, u regjistruan dhe u burgosën nga qeveria fashiste e asaj kohe. Të burgosurit u përballuan me të ftohtit, urinë, dhe sëmundjen që në disa raste rezultuan me vdekjen e tyre.

## PARATHËNIE

Në Itali hulumtimi i persekutimit dhe internimit të romëve mbetet shumë i vogël në terren – posaçërisht hulumtimi akademik – dhe ka pasur një studim të vogël të internimit në një vend, i cili heziton të pranojë bashkëpunimin me nazistët dhe rrjedhimisht përgjegjësinë e ndarë për politikën e asgjësimit.

Për këtë arsye të njëjtë, ka shumë zbrazëtira në faktet dhe numrat e persekutimit fashist të romëve në Itali, dhe vetëm tani, duke iu falënderuar këmbënguljes së disa historianëve dhe kërkuesve, kjo histori e harruar po fillon të tregohet. Fatkeqësisht, shifrat për numrin e viktimave ende nuk dihen. Gjithashtu ende nuk është e mundur të qartësohen arsyet e persekutimit. Por duhet të vlerësojmë që edhe pse persekutimi fashist i romëve nuk mund të kategorizohet definitivisht

VIJA GOTIKE (1945)

VIJA GUSTAV (1944)

KAMPET E ROMËVE ITALIAN  
OSE KAMPET ME TË  
BURGOSURIT ROMË

Ill. 1 (bazuar në Boursiers 1999, f. 24)

ht si pjesë e politikës raciste nga ana e regjimit, që sikurse regjimi i Hitlerit kishte për qëllim që faktikisht të asgjësonte grupet në fjalë, fakti mbetet se romët gjithmonë janë diskriminuar, janë lënë anash dhe persekutuar si “zingari” (“Ciganë”). Dhe kjo sigurisht do të thotë diçka.

## ÇËSHTJA E RACËS


Këmbëngulja zinjte marshuan në Romë dhe, ditën vijuese, Mbreti Victor-Emmanuel III kërkoi nga Benito Mussolini të formonte qeverinë e re. Kjo shoqëroi periudhën e diktaturës fashiste, të karakterizuar me eliminimin – përfshirë eliminimin fizik – e të gjitha grupeve opozitare dhe me një politikë të domini-


mit imperialist që gjithashtu mbështetej në teorinë dhe praktikën racore.

Në vitin 1938 fashizmi zbuloi dhunën e plotë dhe shëmtinë e fytyrës së saj raciste, veçanërisht kundër Çifutëve. Manifesti Racor u publikua në qershor, duke theksuar “dallimet” në mes të racave njerëzore në aspekte të qarta, dhe kjo shpejt u shoqërua me themelimin e Departamentit për Demografi dhe Racë dhe të Gjykatës mbi Racën. Pastaj, në

shtator, ligjet racore kundër çifutëve u miratuan, një pasqyrim i pastër i politikës së dhunshme anti-semite të regjimit.

Në aspektin e ligjit, së paku, romët nuk duken të kenë qenë përfshirë në politikën racore të regjimit. Për këtë arsye gjithmonë është mohuar se ata janë diskriminuar nga pikëpamja racore në Itali. Por që nga fillimi ata kanë qenë shënjestër e politikave mbi ligjin dhe





III. 2 (Détail)

Urdhri ministror për internim i datës 11 shtator, 1940:

“... për shkak të faktit se ndonjëherë ata kryenin krime serioze për shkak të natyrës së tyre dhe metodave të organizimit dhe për shkak të mundësisë që në mesin e tyre ka elemente në gjendje të kryejnë aktivitete anti-nacionale, është e domosdoshme që të gjithë Ciganët të kontrollohen ... Është urdhëruar që ata të nacionalitetit italian, të konfirmuar ose supozuar, të cilët ende janë në qarkullim të rrethohen sa më shpejt që është e mundur dhe të përqendrohen nën mbikëqyrjen e rreptë në një lokalitet të përshtatshëm në çdo provincë ... larg elementeve më të rrezikshme ose të dyshimta të cilat duhet të dërgohen në ishuj ose regjione ...”

(ekstraktuar nga Boursier 1999, f. 18)

rendin. Italia gjithashtu kishte “problemin Cigan” i cili, siç do të shohim, mori formën prej vitit 1926 e më tej dhe u bë gjithnjë më i spikatur pas shpërthimit të luftës.

Sidoqoftë, në vitet e fundit arkiivat kanë shfaqur shumë teorizime për “kërcënimin e supozuar Cigan” të asaj kohe, përfshirë idetë e arkitektëve udhëheqës të politikës racore fashiste, siç ishte Guido Landra, udhëheqës i Zyrës së Studimeve Racore pranë Ministrisë së Kulturës Popullore. Landra, sikurse të tjerët para dhe pas tij, në mënyrë të qartë e bënë këtë çështje si racore, duke mos iu referuar vlerësimeve të tipareve fizike dhe morale të “racës Cigane”. [III. 5]

## NGA TEORIA NË PRAKTIKË

Shumica e atyre që kanë studiuar çështjen e persekutimit fashist të romëve ende nuk e kanë shqyrtuar materialin arkivor, por shpesh e kanë bazuar kërkimin e tyre në dokumentet e shpërndara dhe dëshmitë gojore të grumbulluara gjatë kohës. Sidoqoftë,

ato dokumente kanë ofruar një numër të fakteve interesante, siç është burgimi i romëve në kampin më të madh të përqendrimit në Ferramonti, në Kalabri, ose fakti që disa romët italian u dërguan në Austri dhe Gjermani. Në dëshmitë orale të mbijetuarit shpesh rikujtonin vendet e tyre të burgimit si në Agnona (në Molise), Tossicia (në Abruzzi), Ishujt Tremiti dhe Sardinia. [III. 4]

Pikëpamjet fashiste veç ishin të dukshme në vitin 1926, kur një shpallje urdhëroi përjashtimin e të gjithë “Ciganëve të huaj” nga mbretëria në mënyrë që të “pastrohet vendi nga karvanët Cigane të cilat, pa pasur nevojën të rikujtohen, përbëjnë një rrezik ndaj sigurisë dhe shëndetit publik për shkak të karakteristikave të mënyrës Cigane të jetesës”. Qëllimi ishte të “goditet në zemër të organizmit Cigan.”

Me 11 shtator, 1940, një urdhër ekzistues për internim u lëshua e që gjithashtu kishte të bënte me italianët. Kjo ishte shpallja nga Ministria e Punëve të Brendshme për të gjitha prefekturat, duke i udhëzuar të rrethonin “Ciganët”

## LLOJET E INTERNIMIT

Të burgosurit romë natyrisht i nënshtroheshin rregullave të përgjithshme të internimit në Itali, që përbëhej nga dy lloje të procedurave: internimi në “kampet e përqendrimit” dhe vendbanimi i detyruar në një lokalitet të caktuar (ata duhej të qëndronin brenda lokalitetit dhe nuk lejoheshin të largoheshin). Dy llojet e internimit praktikoheshin gati ekskluzivisht në zonat e largëta dhe fshatrat e vogla, në kushtet e ashpra të jetesës ku të burgosurit i nënshtroheshin një numri të pafund të rregullave të rrepta dhe shpesh mizore për kontrollin dhe mbikëqyrjen e tyre. Ministria e Punëve të Brendshme urdhëroi që kampet të vendoseshin në ndërtesat e braktisura ose ato që rrallë përdoreheshin, larg nga qendrat e rëndësishme strategjike dhe kurdo që ishte e mundur në zonat e largëta. Shumica e kampeve ishin në regjionet e Italisë qendrore, veçanërisht në luginën e Apenineve qendrore dhe në Abruzzi.

III. 3

dhe t’i mbanin në të gjithë vendin “nën mbikëqyrje të rreptë në lokacionin më të përshtatshëm në secilën provincë”. Urdhri u zbatua me zell të madh për burgimin e “Ciganëve”. [III. 2]

## INTERNIMI

Identiteti i të arrestuarve gjithashtu del nga dokumentet e ruajtura në arkiva, posaçërisht dosjet personale, dhjetëra prej të cilave ishin lënë në regjistra ku askush nuk bëri asgjë lidhur me to. Këto janë dëshmi të rëndësishme që na mundësojmë t’i mbledhim pjesët e tregimeve të disa romëve në mes të viteve 1928 dhe 1943. Dëshmitë përshkruajnë përvojat e burrave, grave dhe fëmijëve, tregtarët shëtitës, rritësit e kuajve ose bakërpunuesit, duke udhëtuar përreth dhe shitur shporta të thurura ose rroba të qëndisura, duke u përpjekur të jetonin jetën e tyre përkundër pengesave nga të gjitha anët përmes rregullave dhe rregulloreve të cilat përfundimisht i tërhoqën në tragjedinë e Luftës së Dytë Botërore.

Të gjithë prej tyre, madje edhe ata që pohonin të ishin italian në kohën e

## NË KAMPET ITALIANE– KUJTIMET NGA ROMËT

*Rosa Raidic: “Vajza ime Lalla u lind në Sardinia me 7 janar 1943, sepse ne ishim në kampin e përqendrimit në atë kohë”.*

*Mitzi Herzemberg: “Gjatë luftës ne ishim në kampin e përqendrimit në Perdasdefogu në Sardinia. Çdonjëri ishte i uritur në mënyrë të pashpresë. Një ditë, nuk di se si, një pulë u shfaq në kamp. Unë u hodha mbi të si një*

*dhelpër, e mbyta dhe e hëngra të gjallë, isha shumë i uritur. Ata më rrahën dhe më mbyllën për gjashtë muaj për vjedhje.”*

*Zlato Levak: “Në Itali ne ishim në një kamp përqendrimi, me praktikisht asgjë për të ngrënë. Unë isha afër Campobasso, me familjen time. Kishte shumë nga ne ... në një manastir, të gjithë të mbyllur, me roje përreth, si*

*një burg ... ne kaluam gati dy vjet atje. Djali im më i vjetër vdiq në kamp. Ai pikturonte bukur dhe ishte një djalë i mençur.”*

*Antonio Hudorovic: “Një herë, gjersa ishim në Tossicia, një oficer gjerman erdhi. Ai na mati trupat tonë, madje edhe kokat tona. Ai tha se ishte për rrobat e reja dhe për kapelë.”*

III. 4



III. 5 Fotografitë e “Familjes Cigane” nga një artikull i Guido Landra. Fotografitë duhet të “dëshmojnë” “inferioritetin” e “Ciganëve”. (nga Boursier 1999, f. 16)

arrestimi të tyre, u dëbuan, ri-arrestuan, dhe prapë u dëbuan, në periudhën prej vitit 1928 deri 1940. Pas vitit 1940, arrestimi u pasua me internim, sipas urdhërësës të Ministrisë së Punëve të Brendshme e shtatorit 1940. [III. 3]

Masat e ndërmarra nga regjimi fashist kundër romëve mund të ndahen së paku në dy faza. Në fazën e parë, para shtatorit të vitit 1940, njerëzit e arrestuar u dëbuan nga mbretëria dhe u dërguan në kufi, ashtu që zakonisht ata ktheheshin prapa përgjatë kufirit gati menjëherë, një procedurë që u përsërit në disa intervale. Në fazën e dytë, në mes të viteve 1940 dhe 1943 (ende nuk dimë mjaft për periudhën pas vitit 1943), politika e përjashtimit u zëvendësua me internim.

Detajet e realitetit të burgimit dhe të ndërtesave në të cilat romët mbaheshin u shfaqën gradualisht. Në këtë fazë duket se në disa prej tyre, siç ishin Ishujt Tremiti, Sardinia dhe të tjerat, romët ishin vetëm njëra nga disa “kategoritë” që mbaheshin, por në kampet tjera, posaçërisht në Boiano, Agnona et Tossicia, ata formonin një shumicë të qartë.

Ishte së paku një rast i transferimit të romëve në Gjermani. Kjo kishte të bëjë me familjen Levakovich, babanë, nënën dhe tetë fëmijët, të cilët u transportuan në Rajhun gjerman në fillim të vitit 1944 pas gjashtë viteve të “internimit të lirë” (vendbanim i detyrueshëm) në qytetin e Ravenas. Mirëpo, nuk është e pamundur të zbulohet më shumë për këtë rast nga dokumentet në dispozicion.

### KAMPI

Në Boiano, në Molise, të burgosurit u strehuan në pesë hangarë të një fabrike të vjetër të duhanit, në kushte aq jo humane saqë edhe fashistët kërkonin t’i largonin në ndërtesa tjera. Mirëpo, jo edhe romët dhe Sinti, të cilët u larguan vetëm kur kampi u mbyll në gusht të vitit 1941. Në atë fazë ishin 65 romë (shumë Sinti), 21 nga ta nën moshën 15 vjeçare. [III. 1]

Nga Boiano ata shkuan në Agnona, një tjetër fshat në Molise ku kampi ishte një ish manastir benediktas përmbi fshat në një lartësi mbidetare prej 850 metrave. Këtu shënimet jo vetëm që tre-

gojnë se romët dhe Sinti u mbajtën në kamp; ato gjithashtu sugjerojnë se pas fundit të vitit 1941 kampi u përdor ekskluzivisht për ata. Në korrik të vitit 1942 ishin 250 nga ta në kamp dhe në janar 1943, autoritetet në fakt hapën një shkollë për fëmijët romë ose, më hollësisht, “për mësim intelektual dhe religjioz të fëmijëve të mitur të Ciganëve të internuar aty”. Një dokument i datës 23 prill, 1943, shënon praninë e 146 të burgosurve “Cigan” dhe insiston që çdo gjë është duke shkuar mirë, përfshirë shkollën që është e interesuar t’i “largojë nga shprehitë e tyre vagabonde dhe amorale”. Fatkeqësisht nuk është e mundur të mësohet më shumë për ndryshimet e numrit të të burgosurve, dhe arsyet e tyre, derisa listat e kampit të gjenden dhe të studiohen. Por ekzistojnë dëshmi personale, si ajo e Tommaso Bogdan, një rom që jetonte në Romë, i cili kujton dy vëllezërit e tij që vdiqën nga uria në Agnona dhe prindërit e tij të cilët nuk mbijetuan ikjen e tyre nga kampi.

Kampi në Tossicia ishte funksionale që nga tetori i vitit 1940 dhe u mbyll pas armëpushimit. Në mesin e të burgosurve kishte romë dhe Sinti. Kemi



III. 6  
Në bazë të kushteve të Armëpushimit të 8 shtatorit të viti 1943, të nënshkruar në mes të Italisë dhe Aleatëve, shumë kampe në Italinë jugore u mbyllën. Atëherë romët ikën, duke u shpërndarë nëpër male, në disa raste edhe duke iu bashkëngjitur partizanëve. Kjo fotografi, në posedim të romit Amilcare Debar, tregon grupin e tij partizan, Bragida e 48-të Garibaldi, në vitin 1944.

(nga Boursier 1999, f. 29)

së paku dy lista të cilat tregojnë se së paku 108 nga ta ishin atje në korrik të vitit 1942. Tossicia, në Abruzzi, ishte njëra nga kampet më të këqija në Italinë qendrore. Të burgosurit jetonin të grumbulluar në ndërtesa, dhe romët u strehuan në barakën Mirti ku kushtet ishin të patolerueshme: ndërtesat nuk kishin dritare, nuk kishte ujë dhe kanalizimet vazhdimisht vërshonin.

### PAS ARMËPUSHIMIT

Pas arritjes së Aleatëve në Sicili dhe humbjes së fashizmit, Italia nënshkroi armëpushimin me Aleatët me 8 shtator, 1943, dhe vendi u zhyt në kaos. Familja Mbretërore dhe qeveria

turpshëm ikën në jug, gjermanët okupuan një pjesë të vendit dhe Musolini formoi një qeveri të re fashiste në Italinë veriore, Republikën Socialiste të Salò. Vendi ishte i ndarë dhe pushuar nga trupat e huaja, derisa forcat anti-fashiste organizonin Rezistencën. [III. 6]

Ka shumë pak informata për atë se çka ndodhi me romët dhe Sinti gjatë kohës së okupimit gjerman dhe Republikës Socialiste, aq më pak për atë se çka ndodhi me ata që veç ishin të regjistruar si të burgosur kur armëpushimi u nënshkrua. Ne dimë se disa të burgosur arritën të iknin nga kampet dhe t'i bashkëngjiten partizanëve dhe Rezistencës. Por në rastet tjera të burgosurit qëndruan në kampe, shu-

mica e të cilave atëherë u futën nën kontrollin nazist. Për këtë arsye është e përshtatshme të konsiderohet deri në çfarë mase Italia merr përgjegjësi për transportimin dhe eliminimin pasues të romëve dhe Sinti në kampet vdekjeprurëse të Hitlerit. Duhet së paku të përmendim dëshminë e një gruaje, e cila mbijetoi kampin e Bolzanos (pika transitore për dëbimin në Rajh) dhe e cila kujton "fëmijët Cigan italian" që jetonin me nënat e tyre në një kolibe të vendosur ekskluzivisht për femra. Dhe atë të Vittorio Mayer, një Sinti i cili kujton motrën e tij Edvige, të vdekur në moshën 20 vjeçare në kampin e Bolzanos: "Ajo luftë e fëlliqur! Në mendjen time ende e shoh motrën time, të zënë prapa telit gjembor."

### Bibliografia

**Boursier, Giovanna (1999)** *Gypsies in Italy during the Fascist dictatorship and the Second World War*. In: Kenrick, Donald (ed.) *In the shadow of the Swastika. The Gypsies during the Second World War 2*. Hatfield: University of Hertfordshire Press, pp. 13-36 | **Boursier, G. / Converso, M. / Iacomini, F. (1996)** *Zigeuner. Lo sterminio dimenticato*. Roma: Sinnos | **Fings, K. / Heuss, H. / Sparing, F. (1997)** *From „Race Science“ to the Camps. The Gypsies during the Second World War 1*. Hatfield: University of Hertfordshire Press | **Levakovich, Giuseppe / Ausenda, Giorgio (1975)** *Tzigari. Vita di un nomade*. Milano: Bompiani | **Piasere, Leonardo (ed.) (1996-1999)** *Italia Romani. Vols. 1 and 2*. Roma: CISU | **Viaggio, Giorgio (1997)** *Storia degli zingari in Italia*. Roma: Anicia